



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:178648

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06642789

P.nr.398/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, dhe me pjesëmarrjen e praktikantes Gresa Bajrami, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit A. G. me vendbanim ne B., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4717/2023 të datës 07.08.2023, për shkak te veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve na neni 366 par.1 te KPRK-se, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 23.12.2024, në prani të prokurores se shtetit Nebahate Salihu dhe të pandehurit, me dt 23.12.2024, merr dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

A. G., I lindur me dt. ... ne P., me adrese banimi ne B., nga i ati Xh. dhe e ema Z. e gjinise H., I martuar, I gjendjes se mire ekonomike, me nr. Personal ..., me nr kontaktues ..., shqiptar, shtetas I Republikës se Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 22.07.2023 rreth ores 13:25, ne rrugen "M. Z." ne L. me dashje dhe vetedije e ne kundërshtim me nenin 3, pika 1.7 lidhur me nenin 4 par.1 pika 1.4.4 te ligjit dhe nenit 2 par 1 pika 1.2.1 e Udhezimit Administrativ, pa autorizim ne vende publike posedon arme me gas e llojit si dhe 47 fishek me gas, ne ate menyre qe ditën kritike nga njesia reaguese STP Lipjan ka ndaluar veturen e tipit ... me targa te B.. 2..., ku gjate kontrolles ne qanten e te pandehurit eshte gjetur arma, ndersa fisheket ne veture e te cilat me pas i konfiskohet nga Policia e Kosoves.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së .

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 3, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 366 par.1 të KPRK-së si dhe dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej **200.-€**, (dyqind), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguajë, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ne te kunderten dënimi me burgim, konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, do te zëvendësohet ne dënim me burgim ku do të llogaritet shuma prej 20-€ per nje ditë burgimi.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajë shumën nga 20.-€, dhe në Fondin e viktimave të krimit të

paguajë shumen prej 30.-€, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

URDHËROHET konfiskimi i përherëshëm i sendit–armës, me gas e llojit ..., kalibri 9 mm me numer serik ... si dhe 47 fishekë, e cila është sekuestruar nga ana e policisë me dt.29.07.2023 (2023 AH-0658) dhe detyrohet Stacioni Policor në Lipjan që sendin e konfiskuar ta shkatërroj – asgjësoj pasi që është jashtë qarkullimit juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.4717/23, të dt.07.08.2023 e ka akuzuar të pandehurin A. G. me vendbanim ne B., për shkak të veprës penale, Mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 366 par.1 te KPRK-së. Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje te plote ne shkresat e lendes si dhe baze ligjore konfrom neni 242 te KPRK-së andaj i propozoj gjykates qe ti vleresoj rrethanat renduese dhe lehtsuese me rastin e marrjes se vendimit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale e cila i vihet ne barre, i njejt shton se ndihet i penduar dhe se nuk do ta perserise ne te ardhmen kete sjellje, eshte i moshes se re dhe asnjehere nuk ka qene me pare i denuar, e lut gjykaten qe ti shqiptoi nje denim sa me te bute.

Vleresimi i Gjykates lidhur me pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kunderligjshme, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshir në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë neni 242 të KPPK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat lehtsuese dhe renduese per matjen e denimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së denimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform neni 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se vepres penale, pra faktin se i njëjti për her të parë ka rënë ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i moshes se re që len per te kuptuar se ne te ardhmen mund te behet anetar i dobishem i shoqerise, rrethanat pas kryerjes se vepres pra faktin se i njëjti është penduar për veprën penale, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do t'i përsërisë sjellje te tilla, e veçanërisht pranimin e fajësisë ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë penale të t'pandehurit, pra faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka që qenë i aftë t'i kuptoi sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i tillë konform neni 38 të KPRK-së.

Vendimi per shpenzimet e procedures dhe kompensimi i viktimave.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 450 par. 1 dhe 2 pika 1 dhe 6 të KPPK-së, ku shuma prej 20.-€, për paushall gjyqësor u bazua në bazë të ndërlikueshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20.-€, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e viktimave te krimimit.

Vendimi per konfiskim.

Vendimi per konfiskimin u bazua ne nenin 366 par. 3 të KPRK-së, pasi qe sendi është i ndaluar dhe jashtë qarkullimit dhe detyrimisht duket konfiskuar dhe njeherit u urdhërua shkatërrimi i tij.

Numri i lëndës: 2023:178648
Datë: 23.12.2024
Numri i dokumentit: 06642789

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr. 398/2023, me datën 23.12.2024.

Praktikantja
Gresa Bajrami

G j y q t a r i
AvdirrahmanGashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.